



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Datë: 26.02.2026

PROCES-VERBAL

Këshilli BashkiaK Kamëz i mbledhur sot, në dt. 26.02.2026, në orën 15:00, në mbledhjen e radhës të muajit Shkurt 2026 në sallën e Këshillit BashkiaK, Bashkia Kamëz. Të pranishëm në mbledhje janë 27 anëtar të Këshillit, përfaqësues nga administrata e Bashkisë. Mbledhja mbahet nga Kryetari i Këshillit BashkiaK z.Hysen Koldashi i cili hap mbledhjen me fjalët përshëndetëse.

Kr. Hysen Koldashi: Sipas njoftimit nga sekretaria mbi bazë të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe bazuar në rregulloren e Këshillit BashkiaK 33 datë 21.03.2024; Neni 81 pika 1, sot zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit BashkiaK.

Kr. Hysen Koldashi: Përpara se ta fillojmë, i kalojmë fjalën sekretarisë për prezencën. Ju lutem, sekretaria.

- Sekretaria konfirmon pjesëmarrjen e Këshilltarëve.
- **Kr. Hysen Koldashi:** Paraprakisht hedhim në votim Proces-verbalin e mbledhjes së kaluar të Këshillit BashkiaK. E hedhim në votim. 26-vota Pro, 0-Kundra, 0-Abstenim.
- **Kr. Hysen Koldashi:** Faleminderit! Atëherë, me rendin e ditës jeni njohur, e keni të printuar në tavolinën tuaj, si më poshtë vijon:
 1. Projekt-Vendim Nr.07 datë 23.02.2026 për: “Miratimin e rregullores për përcaktimin e strukturave përgjegjëse dhe procedurave për matjen dhe raportimin e performancës në Bashkinë Kamëz”.
 2. Projekt-Vendim Nr.09 datë 23.02.2026 për: “Miratimin e shpalljes së zonave prioritare të zhvillimit në territorin e Bashkisë Kamëz”.
 3. Projekt-Vendim Nr.10 datë 23.02.2026 për: “Miratimin e rregullores së menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane Bashkia Kamëz”.
 4. Projekt-Vendim Nr.11 datë 23.02.2026 për: “Dhënie ndihme financiare për diegie banese”.
 5. Projekt-Vendim Nr.12 datë 23.02.2026 për: “Një ndryshim në vkb nr.3 dt.26.01.2026 mbi: “Mbi miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionimit të qirasë për ato familje në nevojë që nuk mund të përballojnë qiranë për vitin 2026”.
 6. Projekt-Vendim Nr.13 datë 23.02.2026 për: “Miratimin e realizimit të buxhetit për vitin 2025”.
 7. Projekt-Vendim Nr.14 datë 23.02.2026 për: “Një ndryshim në vkb Nr.90 datë 17.12.2025, për: “Miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2026, 2027, 2028”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

8. Projekt-Vendim Nr.15 datë 23.02.2026 për: Për një ndryshim në vkb nr.97 datë 17.12.2025 për: “Miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, çerdheve, Q.Multifunksionale Kamëz dhe ndërmarrjeve të vartësisë për vitin 2026”.
9. Projekt-Vendim Nr.08 datë 23.02.2026 për: “Dhënie ndihme ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë dhe nga fondi 6% i bllok-ndihmës ekonomike”.
10. Projekt-Vendim Nr.16 datë 26.02.2026 për: “Miratimin në parim për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm, për verifikimin e emërtimeve të përsëritura të rrugëve, shkollave dhe objekteve të tjera publike në Bashkinë Kamëz”.
11. Ndryshim emërtimi të rrugëve në territorin e Bashkisë Kamëz.
12. Informacion Këshillit Bashkiak mbi: Vlerësimin dhe parashikimin afatmesëm të të ardhurave 2026-2028”.
13. Informacion Këshillit Bashkiak mbi: Monitorimin e zbatimit të buxhetit për 12-mujorin vitin 2025”.
14. Informacion Këshillit Bashkiak mbi: Raportin përfundimtar të auditimit financiar për vitin 2024 të KLSH.
15. Informacion mbi: Raportin e veprimtarisë së Këshillit Bashkiak për vitin 2025.
16. Të ndryshme.

Kr. Hysen Koldashi: Pyetje-Diskutime: S’ka. E hedhim në votim rendin e ditës.25-Pro; 1-Kundër, 0-Abstenim. Miratohet.

Ju lutem mund të jepni sqarime për votën tuaj kundra.

Petrit Gjorgji Këshilltar: Përshëndetje. Vota ime kundra konsiston në pikat e rendit të ditës. Janë shumë pika në rend dite.

Kr. Hysen Koldashi: E drejtë pyetja juaj. Në rregulloren Këshillit Bashkiak, që kemi miratuar maksimumi i numrit të projektvendimeve të cilat do të kalohen në një mbledhje të këshillit bashkiak është 15 projektvendime. Dhe në këtë rast kemi 15 pika në total, ku 4 nga këto pika i përkasin informacioneve të përgjithshme nga drejtoria e Financës. Pra, nuk janë të gjitha projektvendime.

Kr. Hysen Koldashi: Atëherë, vazhdojmë me projektvendimet sipas radhës. Na është kërkuar nga drejtori e ndihmës ekonomike që të kalojë i pari si projektvendim për arsye të lëvizjes së përfaqësuesit të drejtorisë, për arsye familjare.

Kr. Hysen Koldashi: Projektvendim numër 08 date 23.02.2026 “Dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë dhe fondi 6% i bllokës së ndihmës ekonomike”. Nëse ka kush nga këshilltarët diçka konkrete, mund të bëjë pyetje ose paqartësi dhe të na



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

shpjegojë. Këshilltarë, kemi pyetje, diskutime të tjera? S'ka. E hedhim në votim. 26 Vota Pro; 0 vota Kundra: 0-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Vazhdojmë me radhë projektvendimet sipas rendit që keni ju në tavolinën tuaj. Projektvendim numër 07 datë 23.02.2026, “Miratimin e rregullores për përcaktimin e strukturave përgjegjëse dhe procedurave për matjen dhe raportimin e performancës në Bashkinë Kamëz”.

Kr. Hysen Koldashi: Ky është një draft që ka ardhur nga Ministria .Kjo është thjesht një shkresë e zyrtarizuar. Kjo kalohet formalisht në këshillin bashkiak dhe është standardizuar se si performohet bashkia me drejtoritë përkatëse dhe është një formular i njësuar për të gjithë bashkitë në Republikën e Shqipërisë. Thjesht është rregullore për të kaluar. Këshilltarë, kemi pyetje, diskutime të tjera? S'ka. E hedhim në votim. 26 Vota Pro; 0 vota Kundra: 0-Abstenim. Miratohet

Kr. Hysen Koldashi: Viojmë me projektvendimin numër 09 datë 23.02.2026 për, “Miratimin e shpalljes së zonave prioritare të zhvillimit në territorin e Bashkisë Kamëz. Po, kemi këshilltarë që ka pyetje. Diskutim. Po? Doktor, këshilltari Petrit Gjorgji.

Petrit Gjorgji Këshilltar. Përshëndetje. Unë doja ta nis me këtë “paketën e maleve” që mua më duket ligji më paradoksal që po miratohet. Unë desha ta them se s'kam ku e them tjetërkund që kjo është paketa më hajdute e kësaj qeverie. Nuk mund të vijnë njerëz pa mund të bëjnë ndarje territoriale në varret e të parëve tanë.

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit, doktor. Një shpjegim: unë e kam thënë që në krye të herës, se unë jam politikan lokal, jo kombëtar, unë dhe ju bashkë e kemi hapin më të vogël. Këshilltarë të tjerë, kemi pyetje, diskutime të tjera? S'ka. E hedhim në votim. 25 Vota Pro; 1 votë Kundra: 0-Abstenim. Miratohet

Kr. Hysen Koldashi: Projekt-vendim nr. 10 datë 23.02.2026 “Miratimin e rregullores së menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane Bashkia Kamëz”. Kemi pyetje nga këshilltarët? S'ka. E hedhim në votim. 25 Vota Pro; 0 votë Kundra: 1-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Vazhdojmë me projektvendimin e radhës. Projekt-vendim nr 11 datë - 23.02.2026 për: “Dhënie e ndihmës financiare për djegje banese”. E keni konkrete dhe të përcaktuara tek relacioni. Këshilltarë, ka kush paqartësi? Kemi pyetje, diskutime të tjera? S'ka. E hedhim në votim. 25 Vota Pro; 1 votë Kundra: 0-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Projekt-vendim nr 12 datë 23.02.2026 “Një ndryshim në vkb nr.3 dt.26.01.2026 mbi: “Mbi miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionimit të qirasë për ato familje në nevojë që nuk mund të përballojnë qiranë për vitin 2026”, Nëse ka kush një



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

pyetje, mund ta bëjë, nëse s'ka, e hedhim në votim. 26 Vota Pro; 0 vota Kundra: 0-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Viojmë me projektvendimin e radhës. Projektvendim numër 13 datë 23.02.2026 për, “Miratimin e realizimit të buxhetit për vitin 2025”. Është buxheti faktik i realizuar për vitin e kaluar. Pra, pra është i rezauruar i gjithi. Nëse ka pyetje-paqartësi, drejtoresha jep shpjegime më të hollësishme. Ka pyetje? Kemi pyetje, diskutime të tjera? S’ka. E hedhim në votim. 26 Vota Pro; 0 vota Kundra: 0- vota Abstenim. Miratohet

Kr. Hysen Koldashi: Kemi projektvendim numër 14 datë 23.02.2026 për, “Një ndryshim në vkb Nr.90 datë 17.12.2025, për: “Miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2026, 2027, 2028”.

Vjollca Smaci Drejtoresha e Financave: Ku kemi të bëjmë me një ndryshim të destinacionit në vlera të vogla dhe ndryshimi i destinacionit është me vlerën rreth 1 milion lekë dhe është për shkollën “Angela Merkel”, sepse salla e konferencës së kësaj shkolle, është pa foni.

Këshilltaria Xhuljana Elezaj: Përshëndetje. Domethënë, ka shkolla që s'kanë fare foni. Për shkollën Angela Merkel, që është investim gjerman, mungon fonia?

Kr. Hysen Koldashi: Shkollat e tjera skanë salla fare. Ato që kanë sallë, i kanë. Ato që s'kanë, nuk kanë. Absolutisht! Ja, do ta them dhe këtë gjënë tjetër, si dhe e goca që tha që ka të bëjë me pjesën e rinisë. Ajo sallë, që ndoshta jemi jashtë temës, jo ndoshta, por jemi jashtë. Ajo sallë ka kapacitet 250 vende dhe mund të rrijmë deri me 350, mund të përdoret për aktivitete të karaktereve të ndryshme në shërbim të komunitetit dhe e keni në dispozicion , falas në shumicën e rasteve, duke përjashtuar rastet kur bëhen aktivitete private. Kemi pyetje, diskutime të tjera? S’ka. E hedhim në votim. 25 Vota Pro; 0 vota Kundra: 1-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Vazhdojmë projekt-vendim nr. 15 datë 23.02.2026, Për një ndryshim në vkb nr.97 datë 17.12.2025 për: “Miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, çerdheve, Q.Multifunkionale Kamëz dhe ndërmarrjeve të vartësisë për vitin 2026”.

Ka të bëjë me indeksimin e pagave, është bërë në rang vendi. Nëse doni shpjegime, mund t'i jap, ndryshe keni tabelat poshtë, i keni të caktuar tek projektvendimi. Kemi pyetje, diskutime të tjera? S’ka. E hedhim në votim. 26 Vota Pro; 0 vota Kundra: 0-Abstenim. Miratohet.

Mbledhjes i bashkohet Këshilltari z.Ismail Shehu

Kr. Hysen Koldashi: Viojmë me pikën 10 të rendit të ditës. Ndryshim i emërimit të rrugëve në territorin e bashkisë së Kamëz. Kemi dy rrugë. Njëra është rrugë pa emër edhe kërkohet të vendoset “Beqir Baçi”. Gjithçka i keni të sqaruara tek relacioni shpjegues. Nëse po, nëse ka kush diçka për të thënë, ose ndryshe hedhim votim. Kemi pyetje, diskutime të tjera? S’ka. E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

hedhim në votim rrugën pa emër në “Beqir Baci”. 27 Vota Pro; 0 vota Kundra: 0-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Viojmë me rrugën për ndryshim emërtimi. Pyetje- diskutime? Bëhet fjalë për një segment të rrugës Coca-Cola.

Xhuljana Elezaj Këshilltare: Përshëndetje. Në cilin segment bëhet fjalë ti vendoset emri? Cilat janë kontributet e dhëna nga personi për komunitetin?? A do të vendoset një tabelë tjetër?

Kr. Hysen Koldashi: Z. Jeton Dani Kryetari i Njësisë jep përgjigje.

Jeton Dani, Administrator Laknas-Valias : Nuk është rruga te lagja ku jetoni ju, është një tjetër segment. Është rruga nga “Universi City” deri te kthesa te ura në Laknas.

Xhuljana Elezaj Këshilltare: Ok. Zakonisht kur bëjmë ndryshimet e emërtimeve të rrugëve, jepet edhe si të thuash historiku ose kontributi që ka dhënë për shembull. Në relacion thuhet, që ka dhënë një kontribut shumë të madh për komunitetin dhe kaq.

Tani si i bie që do vendoset, një tabelë tjetër aty deri te rruga Coca-Cola. Tani segmentin e coptoni në dy, se ne kemi thënë që nuk mund të bëjmë ndryshimin e rrugëve që janë akse kryesore momentalisht?

Kr. Hysen Koldashi: Z. Jeton Dani Kryetari i Njësisë jep përgjigjen. Sigurisht që do të vendosim një tjetër tabelë.

Xhuljana Elezaj Këshilltare: Kemi ngritur komisionin dhe komisioni duhet t'i shohë me shumë vëmendje këto gjëra, sepse në hartë dhe gjithë jetën tonë ne orientohemi me rrugën Coca-Cola, i cili është një segment shumë i gjatë. Pse duhet ta shkurtojmë segmentin?

Kr. Hysen Koldashi: Kemi pyetje, diskutime të tjera? S’ka. E hedhim në votim për ndryshimin e emërtimit të rrugës nga Coca-Cola në Daut Cerpia. 25 Vota Pro; 1 votë Kundër: 1-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Tani, përpara se të kalojmë tek informacionet nga drejtoritë, i propozoj zyrtarisht këshillit, për të parë në terren emrat e rrugëve apo institucioneve nëse kemi dublim të emrave. Kemi problematika, shqetësime nga një numër i konsiderueshëm prindërs, institucionesh, familjesh, fisesh, fshatrash, të ardhur për grupe familjarësh, e tjerë, por dhe shqetësime që kanë ardhur dhe nga adresari , Ministria e Brendshme. Kemi një sërë rrugësh me të njëjtin emër. Pasojë e kësaj ka qenë shkaku se Paskuqani më pare ishte Komunë më vete, dhe



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

kanë vendosur po të njëjtat emërtime në Paskuqan, por atë emër e ka vendosur dhe Bashkia Kamëz. Kemi dhe shkolla, po me të njëjtin emër. Psh. kemi “Domë Nikollë Kaçorri”. Ndryshimi do kemi katër rrugë në njësinë në bashkinë e Kamëz, se kanë të njëjtin emër, edhe po ngatërrohen pa thënë adresat. Edhe atë e kemi që ta bëjmë një gjë të tillë, sepse keni patur këqësinë dhe ju, dhe unë personalisht, dhe qytetarët, se kemi matur ca emra rrugësh ne, dhe sot nuk janë, nuk kanë dalë në sistem akoma. Kemi problematika se kemi shumë rrugë me të njëjtin emër. Ndryshojini këta, bini secila në njësi të vetme, të ketë vetëm një emër. Psh. Shkolla “Domë Nikollë Kaçorri”, po e marrim konkretisht, Pra, kjo do bëhet me pëlqimin e zonës. Duke marrë në konsideratë, popullsia e zonës ka më shumë nga Lura. Kjo do të jetë konsultim më vete, por unë dua të hedh votim vetëm në parim, të miratojë këshilli bashkiak që të ngrihet një grup pune, që të merret enkas vetëm me këtë problem, jo për t'i përcaktuar emrat, por thjesht për t'i diktuar, për të parë sa emra ka, sa rrugë janë me të njëjtin emër, sa institucione me të njëjtin emër, të veprojmë, pastaj do i sjellin në Këshillin Bashkiak. Kërkohet miratimi i Këshillit Bashkiak në parim.

Kr. Hysen Koldashi: Pyetje -diskutime.

Munir Shehu Këshilltar: Tani meqë e kthe problemin e adresave, unë drejtori që kush merret me adresat, nuk e di se cila drejtori merret. Kjo madhëse nuk ka urbanistika, vetëm zotëri. Unë bëj një propozim, po që për ndryshimin e rrugëve të dubluara, jam gjithmonë dakord që. Por jemi pak nxituar se mos bëhet ndarja territoriale nesër, reforma territoriale, dhe do të kemi prapë përplasje.

Munir Shehu Këshilltar: Për mua do të ishin dy propozime, që drejtori i përkatës që merr me këtë punë, bashkë me projektuesit e buxhetit, drejtori i financës që do të bëjë plan prej buxhetit të 2027-s, ta marrin parasysh e këto Po nuk pate adresë të saktë, vjen policia siç erdhi një ditë në një vend dhe shkoi e kërkoi një kriminel dhe ju fut në shtëpi tjetër.

Kr. Hysen Koldashi: Këshillëzimi nënkryetar Shehu absolutisht që qëndron. Problemi është sepse nëse ose si të ndahet, si të bashkohet, si të bëhet, se nuk mund të paragjykojmë se si do veprojnë, se ka një komision që po merret në këtë, të cilët po merren me këtë gjë, por në çdo lloj rasti nuk ka kurse. Problemi i dytë, absolutisht që qëndron. Sekretaria do ta mbajë shënim, drejtorja përkatëse do të marrë parasysh dhe do të veprojmë sa më shpejt të jetë e mundur. Kurse për një buxhet ekstra, flasim kur të vijë koha. Po, urdhëro. Kush e do fjalën tjetër?

Merita Prenga Këshilltare: Jam shumë dakord, sigurisht me stabilizimin e adresave, si më qartë dhe e saktë. Për sa i takon institucioneve shkollore, duhet të mendohemi shumë, sepse nuk mund



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

të qëndrojë emërtimi i të njëjtit në dy shkolla një personi,. Dhe në rast se ne do të veprojmë tek njëra shkollë, duhet të mendojmë që të paktën të jenë në të njëjtin nivel ose të kenë të njëjtat prioritetë për arsimin, për zhvillimin dhe jo të ndalemi në një pikë që bie shumë poshtë tek institucioni pastaj, se ja humbasim vlerat.

Kr. Hysen Koldashi: Komisioni që do të ngrihet duhet t'i marrë parasysh këto gjëra. Komisioni, e bëra të qartë, komisioni është thjesht vetëm të verifikoj ku ka emra rrugësh, pra dy, tre, më shumë se një. Dhe kaq do verifikoj. Pastaj do jetë institucion tjetër ai që do merret .Edhe për emrin e shkollës, edhe ju e thoni më shumë “Domë Nikollë Kaçorri”, nëse më pyet njëri mua se unë jam si ju edhe kam drejt vetëm një votë, jam më shumë se një votë. Domë Nikollë Kaçorri, për mua duhet të rrijë në Laknas sepse ka shumë nga zona e Lurës, aty ka një numër të konsiderueshëm. Gjithsesi, pse e thamë ky, mendimi i vetëm i imi. Pra, do vendosim në Këshillin Bashkiak, nuk vendos unë. Unë thjesht mund të ndjek procedurën, thjesht po ta hedh ose jo në votim dhe kaq. Atëherë, kush është pro propozimit? 27 Vota Pro; 0 vota Kundra: 0-Abstenim. Miratohet.

Kr. Hysen Koldashi: Tani japim fjalën sipas radhës drejtorisë së financave për të dhënë informacionet sipas rendit të ditës. Drejtoresha, fjala për ju.

Vjollca Smaci Dr.Finance: Në këtë material që ju është dërguar, janë të dhëna të gjitha investimet, shpenzimet operative, pagat, çdo gjë sipas programeve buxhetore të ndarë dhe sipas llogarive ekonomike. Mund t'ju them vetëm një gjë që realizimi i të ardhurave, disa shifra realizimi i të ardhurave për vitin 2025 është rreth 85%, është një shifër mendoj e kënaqshme në krahasim me gjithë problematikat që dalin gjatë kësaj periudhe dhe mund të them që mos realizimi ka ardhur vetëm nga mbledhja e taksave dhe tarifave familjare. Vetëm në këtë zë kemi mos realizim, pra diferencë e mos realizimit. Këto dhe ka dhe gjëra të tjera të vogla, por pjesën më të madhe këtë e ka. Megjithatë, të realizosh të ardhurat masën 85%, mendoj që është një shifër e kënaqshme. Shpenzimet, po kam bërë një raport të shpenzimeve ku pjesën më të madhe të bashkisë, pa përfshirë ndërmarrjet e varësisë, për fondet pa përfshirë njëkohësisht dhe fondet që vijnë nga shteti, për fondet të cilat miratohen në këshill, më saktë janë të ardhura dhe transfertë e pakushtëzuar, rreth 48% të këtij buxheti, të këtij realizimit buxhetit e zënë shpenzimet për investime. Pra, pothuajse gjysma e shpenzimeve që janë të ardhura plus transfertat e pakushtëzuar është për investime. Këtu njëkohësisht, pra tek kjo shumë përfshihen edhe është fut në këtë raport edhe transfertat sektoriale. Pra, në qoftë se zbritet dhe transfertat sektoriale, i bie që shpenzimet për investime të jenë mbi 50%. Besoj që asnjë bashki nuk e ka këtë raport.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Kr. Hysen Koldashi: Dëgjo, këshilltarë, ju i keni parë të gjithë informacionet që i keni me shënuar më parë. Nëse ka kush pyetje konkrete, drejtoresha, që ka shumë informacion që mund të merret me këtë. Nuk miratohen, këta se janë thjesht informacion. Pra, nuk hidhen votim fare. Atëherë, faleminderit. Duke falenderuar këshilltarët, vazhdojmë me të ndryshme. Pra, ja të shih. Pra, edhe herë, duke falenderuar këshilltarët për gjithë kontributin e tyre me votën e tyre, bën që projektvendimet e ardhur nga bashkia me votën e tyre të kaluar në vendime. Po kalojmë në pikën e fundit të ndryshme. Kush e do fjalën?

Xhuljana Elezaj Këshilltare: Faleminderit Kryetar. Atëherë, pyetja ime është, ka të bëjë në fakt me abonen e studentit, se patëm një debat kur miratua buxhetin për 2026-ën, sepse nuk u realizua dhe u diskutua që do realizohet në 2026-ën. Doja t'i bëja një pyetje drejtoreshës së financës, a kanë filluar procedurat për abonen e studentit dhe në çfarë fazash janë?

Vjollca Smaci: Kanë filluar. Fazën, unë nuk jam person që kam informacion se në çfarë faze janë, por që fondet janë të mjaftueshme, fondet janë planifikuara, kanë filluar të paktën që këtë muaj, di në dijeninë time, që këtë muaj ka filluar, disa studentë kanë ardhur, kanë bërë kërkesën, janë bërë gati materialet që do ju jepen.

Xhuljana Elezaj: Mbledhjen e ardhshme të kemi një informacion konkret se në çfarë faze është procedura në lidhje me abonen e studentit. Edhe dicka, nëse do ishte e mundur mbledhja e komisioneve të mos bëhet në të njëjtën ditë me mbledhjet e këshillit, pasi e kemi pak të pamundur që të jemi prezent dhe ndoshta do evitoheshin këto debatet në lidhje me projektvendimet.

Kr. Hysen Koldashi: Atëherë, dy përgjigje kam. Përgjigja e parë, drejtorja përkatëse për abonet e studentëve të vitit, të paraqiten me shkrim në mbledhjen e radhës dhe e dyta ka të bëjë me mbledhjen e komisioneve që mos të bëhet një njoftim jo të njëjtën ditë dhe nëse nuk bëhet të njëjtën ditë, pra nëse nuk bëhet komisioni, të lihet për ditën e mbledhjes. Nëse s'bëhet, prapë pason në sallë plenare.

Kr. Hysen Koldashi: Faleminderit të gjithëve dhe gëzohem që jeni mirë. Mbyllet mbledhja, takimi i radhës njoftohet nga sekretaria.

SEKRETAR

Nexhmije TOPI